



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
Komisioneri

Nr. 14/2 Prot.

Tiranë, më 18/5/2011

Lënda: Rekomandim për “Albtelekom” sh.a.

REKOMANDIM

Mbështetur në Ligjin nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”, Vendimet e Kuvendit të Shqipërisë nr.211, datë 11.09.2008 “Për zgjedhjen e komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale” dhe nr 225, datë 13.11.2008 “Për miratimin e strukturës organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të zyrës së Komisionerit për mbrojtjen e të dhënave personale”, pas shqyrtimit të relacionit të Drejtorisë së Inspektimit në ngarkim të kontrolluesit, “Albtelekom” sh.a,

KONSTATOVA

Më datë 21.03.2011 nga grupi i inspektimit të Zyrës së Komisionerit është zhvilluar kontrolli administrativ pranë kontrolluesit, “Albtelekom” sh.a, me cilësinë si kontrollues që mbledh dhe përpunon të dhëna personale në ushtrim të qëllimit dhe aktivitetit të tij, me objekt:

- Të dhënat personale që përpunohen (kategoritë e subjekteve, klientë punonjës etj.).
- Zbatimi i kushteve dhe kritereve të parashikuara në nenet 5, 6, 7, 8, 9 të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Si zbatohen të drejtat e subjekteve të të dhënave personale të parashikuara në nenet 12, 13, 14, 15, 16, 17, të ligjit nr.9887, datë 10.03.2008 “Për Mbrojtjen e të Dhënave Personale”.
- Plotësimi i detyrimit për të njoftuar pranë zyrës së Komisionerit në lidhje me të dhënat personale që përpunohen (neni 21).
- Masat për sigurinë e të dhënave personale (neni 27).
- A përpunohen të dhëna personale nëpërmjet sistemeve të kamerave (CCTV), nëse ka tabela informuese?

